



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.09.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës: Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8318, datë 1. 4. 1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florion Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Majlinda Bozgo - Përgjegjëse e Sekretariatit Teknik në Komisionin Qeveritar të Tokës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç ju kemi vënë në dijeni, sot kemi për diskutim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 1. 4. 1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar”.

Si fillim, jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Dakord.

Relator i këtij projektligji është zoti Marto, kurse data e shqyrtimit në seancë parlamentare është data 24 shtator. Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë kemi zotën Irfan Tarelli dhe zonjën Majlinda Bozgo, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Pa humbur kohë, fjalën e ka zoti Marto, më pas përfaqësuesit e ministrisë dhe në fund do të procedojmë me pyetje dhe diskutime. Dakord me rendin e ditës?

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i kushteve të ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe objekteve në funksion të agroturizmit në tokat bujqësore që janë pasuri shtetërore, me destinacion dhënien me qira të tyre, me qëllim rritjen e investimeve dhe të efektivitetit të përdorimit të tyre.

Duke qenë se gjatë procesit të qiradhënies, ndonëse qiramarrësit kërkojnë të realizojnë të gjithë ciklin që nga prodhimi, ruajtja dhe përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale që marrin nga sipërfaqet e tokës bujqësore, objekti i qiradhënies, lejimi i ndërtimit të objekteve të tilla dhe kushtet sipas të cilave kryhen ato nuk janë të përcaktuara në dispozitat e ligjit në fuqi, është parë e nevojshme të ndërhyhet në ligjin ekzistues duke bërë të mundur realizimin e ndërtimeve përkatëse dhe kushteve specifike të nevojshme, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e qiradhënësit me qiramarrësin.

Konkretisht ndryshimet në projektligj parashikojnë:

1. Dispozita shtesë për lejimin e ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet leje ndërtimi, si dhe ndryshimin e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në tokë “truall”. Këto ndërtime do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit dhe dokumentet përkatëse (planin e përgjithshëm vendor të bashkisë) në territorin e së cilës gjendet toka, objekt i qiradhënies.

2. Për objektet e ndërtuara sipas këtij projektligji, nuk lejohet në asnjë rast që të ndryshohet destinacioni i funksionit të tyre, pasi ato realizohen në shërbim të qëllimit të qiramarrjes.

3. Pas ndërprerjes apo përfundimit të afatit të qiradhënies, objekti ndërtimor kalon në pronësi të qiradhënësit pa shpërblim.

4. Kur mbi sipërfaqen e tokës, objekt i qiradhënies, parashikohet kryerja e një investimi për interes publik, atëherë kompensimi i qiramarrësit për shpenzimet e kryera bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpronësimet për interes publik. Ndërkohë, shfuqizohet dispozita ku parashikohet detyrimi që ka qiradhënësi për të kompensuar qiramarrësin për shpenzimet e kryera, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil dhe të tipit të investimit.

Këto janë ndryshimet që propozohen të bëhen në projektligjin ekzistues.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Marto!

Thelbi është i qartë, kurse pyetja është pse erdhëm te këto ndryshime. Çfarë parapriu? Ka ndonjë kërkesë?

Irfan Tarelli – Faleminderit, zoti kryetar!

Ministria e Bujqësisë ka rreth 20 mijë hektarë tokë shtetërore në dispozicion me destinacion qiradhënien. Aktualisht janë dhënë me qira mbi 3500 hektarë dhe me ndryshimet e bëra së fundi në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji, janë shpallur sipërfaqet e tjera të lira dhe kanë filluar edhe procedurat e aplikimit për qiradhënie. Meqenëse këto janë sipërfaqe relativisht të mëdha, pra, objekt i qiradhënies mund të jenë blloqe 50, 100 hektarë dhe më tepër, sipërmarrje të tilla nuk kufizohen vetëm me kultivimin e bimëve të caktuara, por janë të interesuar për ruajtjen deri në përpunimin e pjesshëm të këtyre produkteve, i cili është një proces normal që realizohet në nivel ferme. Në biznesplanet e tyre, krahas investimit për kultivim, ata kërkojnë ta shoqërojnë edhe me investime të kësaj natyre, të cilat realizohen detyrimisht nëpërmjet një objekti ndërtimor.

Ligji në fuqi, pavarësisht se në dy nene të tij pranon investimet, nuk ka specifikime të qarta se çfarë bëhet me kategorinë e resursit, nga tokë bujqësore të kthehet në truall, dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky investim. Për më tepër nuk parashikon se çfarë ndodh me kryerjen e këtij investimi nëse kontrata përfundon ose ndërpritet për shkaqe të tjera, apo ka edhe raste që për nevoja zhvillimi të projekteve me interes publik mund të kemi prishje të këtyre investimeve. Për këtë qëllim është gjykuar që të bëhen shtesat përkatëse në ligj që jo vetëm mundësojnë kryerjen e këtyre investimeve, kjo do të ishte një vlerë e shtuar krahas mbylljes së ciklit nga investitori privat, por rrisin punësimin dhe kanë shumë efekte të tjera.

Gjithashtu, bëhet edhe një shtesë tjetër, që nuk e ka ligji, ka kërkesa në këtë kategori tokash bujqësore edhe për objekte agroturizmi. Pra, u gjykua që me plotësimin e kësaj kërkesë kryesore të përfshihen edhe objektet e agroturizmit. Nëpërmjet shfuqizimit të pjesshëm të nenit 6 dhe shtesave në nenin tjetër, mendojmë që krijohet e gjithë hapësira e nevojshme, e cila do të reflektohet edhe në vendimin e qeverisë, dhe krijojmë një hapësirë për biznesin dhe një hapësirë shfrytëzimi të këtij resursi të rëndësishëm që ka Ministria e Bujqësisë në dispozicion.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Dua të pyes për një situatë konkrete, nëse një biznesmen ka me letra një sipërfaqe 3 hektarë në një zonë të caktuar dhe, përveç kësaj, ai ka një sipërfaqe po kaq pa letra, Ministria e Bujqësisë dhe ky projektligj është e interesuar t'i përfshijë këto në kushtet kur ai paraqet një projekt zhvillimi në agrobiznes?

Irfan Tarelli – Projektligji nuk e parashikon në mënyrë eksplicite, por nuk përjashton mundësinë që një sipërmarrje e caktuar, që disponon tokë ose një objekt agropërpunimi, ose agrobiznesi në përgjithësi dhe pjesa që kërkon të marrë me qira është në këtë kategorizim, ai mund të aplikojë edhe kundrejt procedurave të garës...

Eduard Shalsi – Irfani thotë se ligji e parashikon. Pra, pyetja e Besnikut ishte që një pronar ka një truall të vetin, por projektin do ta shtrijë përtej pronës së vet, në një sipërfaqe e cila nuk ka pronar, që mund të jetë shtetërore, pra mund ta marrë.

Irfan Tarelli – Vetëm një specifikim, objekt i projektligjit janë vetëm tokat bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, 20 mijë hektarë.

Irfan Tarelli – Sepse mund të jenë nën administrimin e bashkisë ose të një subjekti tjetër.

Eduard Shalsi – Pra, nëse trualli ngjitur është nën administrimin e Ministrisë së Bujqësisë, mund të jetë objekt i projektit.

Fjalën e ka zoti Marto

Andrea Marto – Unë kisha disa pyetje që dolën nga amendimi i ligjit, pyetje që kanë të bëjnë me kuptimin e projektligjit. Dua një shpjegim më të saktë të shfuqizimit të paragrafit, që parashikon kompensimin nga shteti në rast të prishjes së kontratës. Pse është hequr kur kjo parashikohet në Kodin Civil?

E dyta, në nenin 16/1 parashikohet edhe sipërfaqet ndërtimore, ku do të ndërtohen objektet që do të konsiderohen truall. Për këto, a do të aplikohet çmimi i njëjtë me tokën bujqësore?

E treta, me objektet në funksion të agroturizmit, a parashikohen edhe bujtinat?

Për të kuptuar disa gjëra të thjeshta sesi ka ecur deri tani procesi i qiradhënies, unë kam disa pyetje të thjeshta.

E para, si ka funksionuar deri tani procesi i qiradhënies dhe cilat janë problematikat që janë ndeshur më shpesh?

Cila është përqindja e shndërrimit nga zëri kadastral tokë bujqësore në zërin truall?

Nga qiradhënia në ndërtimet e kryera a kemi shumë ndryshime të zërit kadastral nga tokë bujqësore në truall?

Si ka qenë ecuria e kontratave deri tani dhe kontratat janë prishur nga qiramarrësi apo nga shteti?

Për cilat lloje qiradhënie është aplikuar më shpesh, 10, 30 apo 99-vjeçare, pra për cilën kategori ka kërkesa më shumë?

Pyetjet e fundit ishin për ligjin dhe për ndryshimet.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Marto!

A ka pyetje të tjera?

Fjalën e ka zoti Irfan.

Irfan Tarelli – Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja e parë, pse hiqet paragrafi 3 i nenit 6, pra “Qiradhënësi është i detyruar të kompensojë qiramarrësin për shpenzimet e kryera në dispozitat e Kodit Civil dhe tipin e investimit”. Në fakt, është bërë një rregullim, pra paragrafi i tretë i nenit 6 rregullohet me nenin 16/2 dhe neni 16, pika 2 e të cilit përcakton kur kemi të bëjmë me kompensimin për interes publik. Ndërsa kur kemi zgjidhje të kontratës, këto kushte janë të parashikuara në kontratë. Kontrata miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur kemi të drejtën e kompensimit për interes publik dhe kur zhvillohet një projekt me interes publik, barra e kompensimit i ngarkohet entitetit, që realizon interesin publik. Ndryshe, Ministra e Bujqësisë do të ishte në një kolaps të plotë, pra në një rast hipotetik, për të paguar kostot e kompensimit. Kjo dispozitë është në përputhje me ligjin “Për shpronësimet për interes publik”. Pra, nuk kemi mohim të të drejtës së investitorit në këtë rast, por kemi një rregullim në përshtatje me kuadrin ligjor në fuqi. Ligji bazë është i miratuar herët dhe nuk e ka pasur një përcaktim të tillë.

Për sa i përket çmimit në rastin kur sipërfaqja ndërtimore nga statusi tokë bujqësore konvertohet në truall, është parashikuar që të lihet i njëjtë me çmimin e tokës bujqësore. Ka arsye të shumta për këtë punë, jo vetëm si një incentiv ndaj biznesit, por pavarësisht nga afati i kontratës së qiradhënies në këtë rast pronar është vetë shteti. Në qoftë se do të supozojmë një ndryshim të pronësisë edhe kur kontrata përfundon, ose në rastin kur ndërpritet për shkaqe të parashikuara në kontratë, ose në raste të njëanshme, përsëri pronar do të ishte shteti. Ne kemi gjykuar që kjo barrë të mos i ngarkohet biznesit, por të jetë një barrë e arsyeshme. Kjo, nisur edhe nga praktikat e vendeve të tjera, të cilat në shumicën e rasteve ndërtimet mbi tokat bujqësore nuk i konsiderojnë si truall, por i konsiderojnë si pjesë organike të realizimit të një aktiviteti bujqësor. Është propozuar që të mbahet një qëndrim i tillë, sepse po të shikojmë edhe praktikat aktuale, kemi paradokse që për një stallë të ndërtuar nga një fermer, qoftë edhe modeste, për efekt të kadastrës fiskale, aplikohen çmime të papranueshme, që rëndojnë atë që investon. Për këtë arsye është mbajtur edhe një qëndrim i tillë.

Eduard Shalsi – Kjo afekton vetëm tokat e dhëna me qira?

Irfan Tarelli - Po.

Eduard Shalsi – Po për pjesën tjetër?

Irfan Tarelli - Ne mendojmë t'i bëjmë një propozim Ministrisë së Financave edhe për pjesën tjetër. Kjo kërkesë vjen edhe nga bizneset, por edhe nga agrofermerët. Të paktën, meqenëse kemi në këtë ligj, ne të bëjmë hapin e parë.

Eduard Shalsi – Dakord!

Irfan Tarelli - Për sa i përket agroturizmit, nëse përfshihen ose jo bujtinat, bazuar në ligjin e turizmit dhe në një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, përcaktohen kriteret se cila quhet agroturizëm. Referenca në këtë rast është ligji dhe VKM-je përkatëse. Pra, janë disa kriterë që duhen plotësuar, në mënyrë që certifikohesh si subjekt i agroturizmit.

Si ka funksionuar qiradhënia? Faktikisht Ministrisë së Bujqësisë i janë transferuar në vitin 2013...

Eduard Shalsi – A janë respektuar kushtet e kontratave? Domethënë, nëse një person e ka marrë tokën me qira për të mbledhë pemë, a e ka verifikuar njeri nëse janë mbjellë pemë, apo jo?

Irfan Tarelli - Ministra e Bujqësisë ka filluar procesin e qiradhënies në vitin 2013, ndërsa sipas këtij ligji kanë pasur të drejtë drejtoritë e bujqësisë në rrethe për të dhënë toka me qira. Vetëm në vitin 2013 është transferuar një fond prej 18 mijë hektarësh dhe atëherë ka

filluar procesi i qiradhënies, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, ku përcaktoheshin kriteret dhe procedurat.

Eduard Shalsi – Kush i jepte më parë?

Irfan Tarelli - I jepnin vetëm drejtoritë e bujqësisë së rretheve në zbatim të këtij ligji. Bëhet fjalë për një sipërfaqe të vogël prej 600-700 hektarësh në shkallë vendi, por një pjesë e kontratave janë drejt zgjidhjes ose janë zgjidhur. Tani po ky fond i transferohet Ministrisë së Bujqësisë për ta administruar.

Procedura e ndjekur nga Ministria e Bujqësisë ka prodhuar dhënien e një numri kontratash me një sipërfaqe prej 3500 hektarësh, por ka pasur problematika në lidhjen dhe zbatimin e këtyre kontratave. Për këtë arsye Ministria e Bujqësisë bëri një auditim të plotë të procesit dhe, së fundi, u bënë përmirësime dhe specifikime më të qarta në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Për sa i përket monitorimit, ka pasur defekte. Edhe me kontratat po procedohet një nga një në varësi me kushtet e tyre, duke ushtruar penaltete deri në zgjidhje të njëanshme. Pjesa më e paqartë dhe një nga arsyet shtesë pse iniciuam këto ndryshime në këtë projektligj ka qenë që në planet e bizneseve subjektet aplikuese paraqisnin edhe projekte investimesh dhe bordi i qiradhënies nuk ka qenë shumë i qartë si t'i adresonte këto probleme. Kontratat e lidhura kanë qenë shpesh të interpretueshme, por, nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë nuk ka bërë asnjë kalim të ndryshimit të kategorisë së resursit. Edhe me këto kontrata ka pasur probleme të kësaj natyre.

Arsyet e prishjes së kontratave kanë qenë nga më të ndryshmet, si nga mospërmbushja e detyrimeve të qiramarrësve, por edhe nga disa angazhime që Ministria e Bujqësisë duhet t'i përmbushte në kuptimin e dorëzimit korrekt të sipërfaqes së tokës, të regjistrimit të kësaj sipërfaqe, me barrë hipotekore e të tjerë. Megjithatë, ne mendojmë se me ndryshimin e vendimit të Këshillit të Ministrave do të krijohet një strukturë e posaçme në ministri, që do të monitorojë kontratat. Bordi i qiradhënies ka dhënë detyra shumë më specifike dhe mendojmë se procesi po shkon në ecuri normale.

Numri i aplikimeve pas vendimit të Këshillit të Ministrave ka filluar të rritet. Vendimi i Këshillit të Ministrave bën përmirësime thelbësore në kuptimin e transparencës. Pra, sipërfaqet e tokave janë tashmë publike. Ka një grup verifikimi, që verifikon në terren përpara se të lidhet kontrata, sepse...

Eduard Shalsi – Ku janë publike? Janë të shpallura?

Irfan Tarelli – Të shpallura.

Eduard Shalsi – Janë në *website*-in e kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Irfan Tarelli – Te faqja e ASIG-ut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Në faqen e ASIG-ut dhe në faqen e Ministrisë së Bujqësisë.

Tek ASIG-u janë të pasqyruara edhe në hartë, me aq mundësi sa na ka dhënë sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Eduard Shalsi – Pra, nëse klikohet te faqja e Ministrisë së Bujqësisë, ka një dritare që u jep njerëzve mundësinë të shohin tokat me qira. Për një informacion më të detajuar, pastaj mund të shkosh tek ASIG-u?

Majlinda Bozgo – Po, listën e tokave me qira dhe legjislacionin përkatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Domethënë, Ministria e Bujqësisë të orienton te linku i ASIG-ut?

Majlinda Bozgo – Po.

Eduard Shalsi – Dakord.

Vazhdo, Irfan.

Majlinda Bozgo – I kemi plotësuar jo vetëm me listë të thjeshtë, por edhe me të dhëna të tjera që e ndihmojnë kërkuesin.

Eduard Shalsi – Dakord.

Irfan Tarelli - Për sa i përket afatit të qiradhënies, ligji në fuqi parashikon një afat qiradhënieje deri 99 vjet për rastin e kulturave të mbjella, si ulliri. Ka edhe një klauzolë tjetër. Kontratat afatshkurtra ose të ndërmjetme, pra që i takojnë shumicës së pemëve frutore 20-30-vjeçare, në rast se shoqërohen me investime të natyrës së agropërpunimit, konsiderohen si afatgjata.

Ne nuk kemi propozuar një ndryshim të tillë, me idenë që tek investitori të ketë garanci dhe kur të bëjë një investim (dhe këtu flasim për investime jo të vogla), të ketë një siguri për investimin e tij në terma afatgjatë.

Eduard Shalsi – Tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbarove me pyetjet e Andreas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bici, pastaj zoti Sinaj.

Dritan Bici – Kam një pyetje. Kur është ndarë toka sipas ligjit nr. 7501, agronomëve u është dhënë një tokë për përdorim. Si do të vazhdojë ky proces? Do ta ketë agronomi atë tokë në përdorim apo ka ndonjë ligj tjetër?

Majlinda Bozgo – Nëse agronomët kanë qenë banorë të njësisë, të fshatit, ku është toka me qira dhe ata nuk kanë marrë aktin e marrjes së tokës në pronësi, atëherë ata duhet t'i drejtohen njësisë administrative dhe bashkisë përkatëse për ta plotësuar atë, nëse e disponojnë tokën dhe e përdorin për qëllime bujqësore. Deri në fund të vitit është në fuqi ligji “Për plotësimin e titullit të pronësisë”, nëse është banor i fshatit ku është toka. Nëse nuk është banor i fshatit ku është toka, ai do ta mbajë dhe do ta përdorë tokën për aq kohë sa institucionet e tjera nuk e kanë përcaktuar pronarin për atë sipërfaqe toke.

Dritan Bici – Domethënë, nëse është banor ai mund të pajiset me titull pronësie?

Majlinda Bozgo – Po, nëse është banor. Nëse nuk është banor i fshatit, por është banor i qytetit, atij...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai mund ta mbajë në përdorim tokën, për sa kohë bashkia apo institucionet si komisionin i kthimit të pronave apo institucione të tjera, nuk kanë përcaktuar një pronar tjetër. Nëse nuk ka pretendime për atë tokë, mund t'i drejtohet bashkisë për ta marrë me qira.

Eduard Shalsi – Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Kam dy pyetje.

Së pari, doja të dija sa toka bujqësore ka në pronësi Ministria e Bujqësisë?

Eduard Shalsi – 20 mijë hektarë.

Vullnet Sinaj – Së dyti, flitet gjithmonë nga Ministria e Bujqësisë për dhënien me qira për një afat të gjatë. Po shitja e këtyre tokave bujqësore të Ministrisë së Bujqësisë pronarëve apo privatëve, është menduar ndonjëherë? Është parë si opsion? A lejohet?

Irfan Tartelli – Siç e thashë, kjo është sipërfaqja, jo në pronësi, në administrim, pra ka të drejtë qiradhënieje. Pronar është shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë në çdo rast, ndërsa shitja e tokës bujqësore ndalohet me një ligj tjetër (do më falni, se nuk e mbaj mend titullin e ligjit), që thotë: “Nuk lejohet shitja e tokave bujqësore deri në procesin e përfundimit të kthimit dhe kompensimit të pronave”. Mendimi ynë është që jemi ende herët. Pa mbyllur plotësimin e titujve të pronësisë, që të arrijmë në një situatë afërsisht të qartësuar, do të ishte gabimi lejimi i tij, sepse mund të krijonte mbivendosje dhe probleme të tjera.

Eduard Shalsi – Dakord.

Zoti Suli...

Rakip Suli – Meqenëse folët për tokat bujqësore, çfarë qiraje ka një hektar në vit afërsisht? Nëse keni informacion, nëse nuk keni informacion nuk ka problem.

Irfan Tartelli – Vendimi i Këshillit të Ministrave, që përcakton kriteret dhe procedurat, përcakton edhe çmimin minimal të qiradhënies, që lidhet me disa faktorë. Faktori

i parë është boniteti ose e thënë më thjesht, pjelloria, kapaciteti prodhues i tokës. Faktorë të tjerë janë: është nën ujë ose jo; ka infrastrukturë rrugore ose jo; largësia nga tregjet e mundshme ose jo... Më pas detajohet me udhëzim ministri. Gjithsesi, në vendimin e qeverisë janë çmimet minimale për të cilat lejohet toka. Çmimi minimal i hektarit është 6 mijë lekë të rinj, ndërsa maksimumi shkon deri në 20-22 mijë lekë të rinj për hektar. Të kuptohemi, është çmimi minimal, poshtë të cilit nuk mund të lidhet kontrata, ndërsa çmimi i tregut vendoset nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vit për hektar, si çmim minimal poshtë të cilit nuk zhvillohet procedura.

Gjithmonë e parë si prag minimal tavan, në raport me cilësinë më të mirë të tokës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, e mbyllim diskutimin mbi projektligjin. Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit, Irfan!

MBYLLET MBLEDHJA